



A.nr.157/2026

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.157/2026, të datës 11.02.2026, të parashtruar nga ankuesja F.D, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Inspektoriati Qendror i Punës, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.05.2026, mori këtë:

## V E N D I M

**Pezullohet** procedura administrative e filluar sipas ankesës me numër A.nr.157/2026, të datës 11.02.2026, të parashtruar nga ankuesja F.D.

### A r s y e t i m

Nëpunësja civile F.D (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 11.02.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mosveprimit të Inspektoratit Qendror të Punës për pagesë të pagës sipas aktit të emërimit me Nr.1870 të lëshuar nga Divizioni për Burime Njerëzore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 20.02.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektoriati Qendror i Punës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 13.05.2026, ka përcjellë përgjigje në ankesë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 752/2026 të datës 11.02.2026, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; ID Identifikuese e ankueses; Akt emërimi i datës 24.09.2025; Vendimi për transferimin e nëpunësit civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit i datës 13.08.2025; Kërkesa e datës 06.02.2026 e ankuesit; Përgjigjja e datës 11.02.2026; Emaili i datës 04.12.2026 nga Thesari i Kosovës; Listat e pagave.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas administrimit të provave të ofruara vetëm nga pala ankuese dhe shqyrtimit të përgjigjes më shkrim të Inspektoriatit Qendror të Punës, vlerëson së janë

plotësuar kushtet ligjore për pezullim të procedurës së filluar sipas ankesës A.nr.157/2026 të datës 11.02.2026, sepse:

Nga provat materiale të çështjes rrjedhë se:

Kryeministri i Republikës së Kosovës me Vendimin Nr.153/2024, të datës 04.09.2024, ka miratuar Rregulloren (ZKM) nr.01/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Inspektoratin Qendror të Punës.

Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin me numër V.nr. 2385/2025, të datës 29.11.2024, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për Inspektoratin Qendror të Punës, ku ky i fundit, më datë 07.05.2025 ka miratuar Raportin përfundimtar lidhur me procesin e ristrukturimit në Inspektoratin Qendror të Punës, ashtu që, ankuesi është propozuar të transferohet në një vend të ri brenda Ministrisë apo Agjencive vartëse.

Komisionin e Ristrukturimit për Inspektoratin Qendror të Punës, më datë 13.08.2025, përmes Raportit me numër protokollit 1550 ka bërë plotësimin dhe ndryshimin e Raport Nr.Prot.942 date 07.05.2025, duke propozuar që ankuesja të caktohet në pozitën Zyrtar i Arkivës, Divizioni i Arkives / Departamenti për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshmen, ndërsa, sipas Vendimit me numër protokollit 1663 të datës 13.08.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, i njëjti është caktuar në pozitën Zyrtar i Arkivës, sipas raportit të datës 13.08.2025 të Komisionit të Ristrukturimit.

Më datë 24.09.2025, Menaxheri i Personelit ka lëshuar për ankuesen Aktin e Emërimit me numër protokollit 1870, për pozitën Zyrtar i Arkivit me Kategorinë dhe Klasën Profesional 2 dhe me koeficient të pagës 115-Cd, 6.10.

Më datë 26.11.2025 Menaxheri i Personelit i Inspektoratit të Punës, kërkon nga Thesari i Kosovës/MF ndryshim në pagë për ankuesen, ndërsa, me datë 26.11.2025, Thesari i Kosovës përgjigjet duke potencuar se pozita e ankueses nuk është e planifikuar me PCF tabel.

Më datë 06.02.2026 ankuesja i drejtohet Menaxherit të Personelit të Inspektoratit të Punës për mos ndryshim të pagës nga Profesional 3 në Profesionale 2, ndërsa, më datë 11.02.2026 ankuesja parashtron ankesë në KPMSHCK kundër mosveprimit të Inspektoratit Qendror të Punës për pagesën sipas aktit të emërimit me Nr.1870 të lëshuar nga Divizioni për Burime Njerëzore.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se edhe përkundër faktit që është përfunduar procesi i ristrukturimit sipas procedurave ligjore, nuk janë zbatuar akt emërimet në relacion me pagën që është përcaktuar sipas aktit të emërimit. Kërkon të aprovohet ankesa si dhe të obligohet Inspektorati i Punës për realizimin e pagës sipas akt emërimit.

Kolegji i Këshillit thekson faktin së procesi i ristrukturimit në Inspektoratin Qendror të Punës, sipas Rregullores (ZKM) Nr.01/2025, është përshkruar më pakënaqësi nga zyrtarë të këtij institucioni, ashtu, që Këshilli duke vepruar sipas ankesës së nëpunësit civil G.E, më Vendimin A.nr.1413/2025, të datës 30.01.2026, ka kthyer çështjen në rishqyrtim me detyrimin që Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, si njësi përgjegjëse për procesin e ristrukturimit të institucioneve të administratës shtetërore të ketë parasysh ligjshmërinë e emërimit të anëtarëve të Komisionit të Ristrukturimit të propozuar nga Inspektorati

Qendror i Punës, andaj, mbi këtë rrethanë, procesi i ristrukturimit në IQP nuk konsiderohet si përfundimtar, dhe mbi këtë fakt, Kolegji nuk mund të vendos meritorisht lidhur me këtë çështje, pa përfundim të ristrukturimit në IQP, e që në vlerësimin e Kolegjit përbën çështje paraprake, kështu që, në kuptim të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: “Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: ”çështje paraprake”), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit”, Kolegji vlerëson se procedura lidhur me ankesën A.nr.157/2026, të datës 11.02.2026, të pezullohet deri në përfundimin e procesit të ristrukturimit nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë lidhur me Inspektoratin Qendror të Punës.

Bazuar në të gjeturat e lart theksuara, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konstaton se me evitimin e rrethanave që kanë sjellë pezullimin e kësaj procedure, Kolegji do të vendos në mënyrë meritorie lidhur me ankesën e pezulluar sipas këtij vendimi.

Sic u tha më lartë, e duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:** Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.157/2026

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

### Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, F.D;
- IQP: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendror të Punës
- Arkivit të KPMSHCK-së.